

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“APSUS”SHPK**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME  
NENI 1**

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, sot, me datë 16/05/2022, me vullnetin e tyre të lirë, Ortaku i vetëm:

- Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L42223008U, me seli në adresën: Tiranë, Rruga “Brigada 8”, Kati 7, Ap.Nr.21 dhe Nr.22, me aksionar të vetëm Z.Alban Peza, dhe me Administrator Z.Alban Peza

si themelues i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi të shoqërisë, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**KREU II**

**EMRI, FORMA, SELIA, KOHËZGJATJA**

**NENI 2  
EMRI DHE EMËRTIMI TREGTAR**

- 2.1 Emri i shoqërisë është “Apsus”shpk.
- 2.2 Emërtimi tregtar i shoqërisë është “Apsus”.

**NENI 3  
FORMA**

- 3.1 Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara për kapitalin.

**NENI 4  
SELIA**

- 4.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Tiranë, Rruga “Brigada 8”, Ndërtesa Nr.4, Kati 7, Ap.Nr.21&Nr.22..
- 4.2 Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.
- 4.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Me vendim të Administratorit mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.



**NENI 5**  
**AFATI**

5.1 Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

**KREU III**

**O B J E K T I**  
**NENI 6**

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Investim me pjesëmarrje, blerje, shitje, në kuota, aksione dhe tituj të tjerë në shoqëritë tregtare;
- Shoqëria mund të marrë pjesë me financime të zotërojë, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi;
- Investimi në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), si dhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të trete (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, etj.) në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.
- Shitblerja e mallrave të ndryshme;
- Shitblerje e pasurive të paluajtshme;
- Ndërmjetësime financiare;
- Ndërmjetësime në fushën e industrisë së naftës dhe gazit;
- Të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie e marrje me qira;
- Të kryejë çdo aktivitet tjetër fitimprurës në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- Të kryejë çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**KAPITALI**  
**NENI 7**

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000(njëqind mijë) Lekë. Ortaku i vetëm Themelues kontribuoi në kapitalin themeltar të shoqërisë si më poshtë:

- Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha kontribuon në kapitalin themeltar të shoqërisë me 100,000(njëqind mijë)Lekë.

7.2 Kapitali Themeltar i shoqërisë “Apsus”shpk përbëhet nga 1 (një) kuotë, e zotëruar nga ortaku i vetëm:

- Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha zotëruar i 1(një) kuote me vlerë100,000(njëqind mijë)Lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



7.3 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

## NENI 8 KUOTAT E KAPITALIT

- 8.1 Kuota mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.
- 8.2 Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.
- 8.3 Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.
- 8.4 Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

## KREU IV ORGANET E SHOQËRISË

### NENI 9

- 9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- Asambleja e Përgjithshme;
  - Administratori.
- 9.2 Fusha e veprimt, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Statutit të shoqërisë.

## ORGANI ADMINISTRATIV

### NENI 10

- 10.1 Administrator i parë i shoqërisë është:
- Miken Dervishi, identifikuar nga letërnjoftimi me nr.035086937.

## NENI 11 DISPOZITA E FUNDIT

11.1 Ky akt themelimi është hartuar në 2(dy) kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

**THEMELUES**  
**Shoqëria “Anio Oil&Gas”sha**  
**Përfaqësuar nga Aksionari i vetëm**  
**Alban Peza**

